



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 23.06.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **20.06.2025**, të parashtruar nga **JAGUAR SECURITY SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi Fizik i Objektivit të Msh-së Depos së Barnave dhe Objektivit të Marrur me Qira për Tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërisht”** me nr. prokurimi 206-25-5497-2-2-5, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE JAGUAR SECURITY SH.P.K. e dt. 20.06.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Sigurimi Fizik i Objektivit të Msh-së Depos së Barnave dhe Objektivit të Marrur me Qira për Tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërisht”** me nr. prokurimi 206-25-5497-2-2-5, kundër Njoftimit për kontratë të datës 22.05.2025;
2. **Vërtetohet**, Njoftimi për kontratë i datës 19.06.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE JAGUAR SECURITY SH.P.K. me datën 20.06.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sigurimi Fizik i Objektivit të Msh-së Depos së Barnave dhe Objektivit të Marrur me Qira për Tri Inspektoriatet dhe DSHB në Lagjen Lakërisht”** me nr. prokurimi 206-25-5497-2-2-5. Autoriteti Kontraktues me datë 23.06.2025 e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

Ligji për Prokurimin Publik
Neni 7
Neni 27
Neni 28

Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 11

Neni 17

Neni 19

Pretendimet ankimore te OE ankues:

Të nderuar

Si palë e interesit konform Nenit 4.1.26 të LPP-së më afatin e lejuar ligjor bazuar në Nenin 108/A të LPP-së dhe Nenit të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik paraqesim këtë:

KËRKESE PËR RISHQYRTIM

Bazuar ne dosjen e tenderit te procedures se negociuar pa publikim te njoftimit per kontrate dhe pas analizimit te kerkesave dhe specifikimeve teknike kemi verejtur qe nuk jane te qarta informacionet e dhena dhe nuk jane te formuluar sakte per shkak se kemi konfuzitet ne kerkesat qe jane paraqitur nga Autoriteti Kontraktues ne menyren se si te kalkulohet oferta.

11.3 Zyrtari i prokurimit (ZP) përveç obligimeve tjera do të ketë edhe përgjegjësitë në vijim:

a. b. Për atë që mundet, siguron se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë; Në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Parallogaritë dhe vizatimet;

Kerkesat per rrespektimin e Ligjit te Punes duke treguar shtesat qe ju takojne punetoreve sipas Nenit 56 te po ketij ligji nuk jane te definuar se a duhet te kalkulohen se bashku me ofertim apo thjesht eshte informate ligjore se keto shtesa ju takojne punetoreve mirepo a paguhen a nuk paguhen nuk eshte pergjigjur.

17.12 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.

Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasyshë, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve.

17.15 Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së tenderit. Ai është plotësisht përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, kriterëve të përzgjedhjes,

si dhe kriterëve të dhënies, ndërsa specifikimet teknike do të përgatiten nga struktura të specializuara në çështjen që do të prokurohet, brenda AK. Në rastet e kontratave komplekse ose të veçanta, AK mund të caktojë ekspert të jashtëm ose Kontraktorë, për të ndihmuar njësinë në hartimin e Dosjes së Tenderit. AK do të zbatojë dispozitat e LPP-së kur angazhohen ekspert të jashtëm ose Kontraktorë.

Per shkak te mundesise se manipulimit ne menyren e llogaritjes se ofertave Autoriteti Kontraktues duhet te definoj qarte se qka do te merret parasysh ne vleresim lidhur me cmimet qe operatoret ekonomik duhet te llogarisin pos pages neto, keto dilema duhet te hiqen nga Autoriteti Kontraktues per operatoret ekonomik qe deshirojne te ofertojne.

17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose

b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Autoriteti Kontraktues duhet te tregoj se cilat kushte te punes duhet te referohen ne menyren e llogaritjes se cmimit.

17.24 Autoritetet Kontraktuese mund të referohen në kushtet e përformancës së kontratës të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike.

17.26 Një Autoritet Kontraktues mund të specifikojë në dokumentacionin e kontratës institucionin apo institucionet nga të cilat një kandidat apo tenderues mund të marrë informatat e duhura për obligimet që kanë të bëjnë me tatimet, mbrojtjen e mjedisit, dispozitave të mbrojtjes së punëtorëve dhe për kushtet të cilat janë në fuqi.

Me specifikimet teknike të cekura në dosjen e tenderit është një hapësirë që operatorët ekonomik mund të ofrojnë çmime manipulative gjatë krijimit të ofertave të tyre, andaj për të ju shmangur favorizimeve AK duhet të sqaroj mirë se kush do të eliminohet nga vlerësimi, cilat oferta; si dhe qka duhet të kalkulohet pasi që me rastin e parashikimit të vlerës së kësaj kontrate duhet të tregoj se si ka ardhur deri tek çmimi njësi prej 6,000€ në muaj apo 18,000€ për tre muaj.

19.3 Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jodiskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, përformanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit. AK do të tregojë nëse specifikimet teknike të specifikuara janë obligative apo kërkesa minimale. Përdorimi i standardeve mund të përfshijë standarde të sigurimit të cilësisë siç është cekur në Nenin 70 të LPP-së.

Bazuar në të cekurat më lartë kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të marrë këtë:

VENDIM

1. APROVOHET e bazuar kërkesa për rishqyrtim,
2. KORRIGJOHET dosja e tenderit dhe zgjatet afati për dorëzimin e ofertave.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Ofertues në këtë aktivitet të prokurimit kemi shpenzime të konsiderueshme për rishqyrtim të vendimit në AK në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material e i cili shtrihet edhe në raport me Neni 136 dhe Neni 137 të LMD-së duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konstatojmë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara dhe kërkesa si e tillë e demton AK-MSH, meqëse ne jemi pa shërbim aktualisht dhe ky aktivitet është bërë i domosdoshëm për shkak se aktiviteti i rregullt me nr. prokurimi 206-25-1648-2-1-1 është i pezulluar pas ankesës ankesë në OSHP pikerisht nga ana juaj si OE.

Ne me qëllim të mosdiskriminimit të OE, u kemi dërguar ftesa 9 OE, ndërsa ju ne vend që ta provoni fatin dhe të oferoni, po bëni ankesa duke e penguar punën e AK-MSH dhe duke shkaktuar dëm dhe mungesë të shërbimeve të sigurimit fizik.

Sa i përket parashikimit të vlerës së kësaj kontrate duhet të tregoj se si ka ardhur deri tek çmimi njësi prej 6,000€ në muaj apo 18,000€ për tre muaj, kjo është bërë nga Njesia e Kërkesës në MSH - Departamenti për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme.

Sa i përket kalkulimit të ofertave, është çështje e OE se si i kullojnë fitimet e tyre, për neve si AK është me rëndësi që kompania fituese të ketë të angazhuar 11 (njëmbëdhjetë) punëtor.

- Depo Qendrore të barnave 24 ore / 7 dite të javës,
- Porta kryesore e objektit të MSh-së 24 ore / 7 ditë të javës
- Objekti i Ministrisë së Shëndetësisë 08:00-16:00 / 5 ditë të javës
- Objekti i Inspektoratit Shëndetësor 08:00-16:00 / 5 ditë të javës

Gjithashtu çdo ofertë që nuk e mbulon prapë e shpenzimeve të pagave të punëtorëve do të shpallet e papërgjegjshme. Nga OE kërkohet që paga mujore për një punëtor të jetë së paku 360 € neto, duke marrë parasysh Vendimin e Qeverisë se RK nr. 02/218 të datës 28.08.2024 për pagën minimale 350 euro bruto (vendimi i cili ka hyrë në fuqi me datën 01.10.2024).

Sipas këtij vendimi paga minimale Neto i bie të jete afër 326 euro, andaj si një mesatare kalkuluar edhe shtesat tjera është marrë çmimi **360 € neto**.

Me këtë çmim konsiderojmë se plotësohet Vendimi i Qeverisë për Page minimale, si dhe punëtorët e kanë edhe një shumë prej 34 euro si mesatare e shtesave sipas Ligjit të punës në fuqi.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit